

# GJYKIMET PRANË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

JANAR - QERSHOR 2022



## PËRMBAJTJA

RASTET NË PROCEDURËN PARAPRAKE

RASTI NË DHOMËN E SHKALLËS SË PARË

RASTET NË DHOMËN E APELIT

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) i monitoron proceset gjyqësore që zhvillohen pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës. FDHK publikon buletine dhe analiza që lidhen me punën e Dhomave të Specializuara, të cilat i shërbejnë publikut të gjerë për të qenë më të

informuar mbi ecurinë e çështjeve gjyqësore.

Në këtë buletin janë paraqitur informatat e përgjithshme mbi ecurinë e gjykimeve para Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) përgjatë periudhës gjashtë mujore janar - qershor 2022.

Aktualisht, pranë DHSK janë duke u trajtuar katër (4) raste. Prokurori kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve dhe Prokurori kundër Pjetër Shalës janë ende në procedurën paraprake, Prokurori kundër Salih Mustafës është në gjykim para Dhomës së shkallës së parë, ndërsa Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinaj është në gjykim para Dhomës së Apelit.



## RASTET NË PROCEDURËN PARAPRAKE

**Prokurori kundër Pjetër Shalës** - I pandehuri Pjetër Shala akuzohet nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) për krime të luftës sipas të drejtës ndërkombëtare. Aktakuza kundër tij është konfirmuar në datën 12 qershor të vitit 2020, kurse i pandehuri është arrestuar në datën 16 mars të vitit 2021 në Belgjikë dhe është transferuar në njësinë e paraburgimit në Hagë në datën 5 prill të vitit 2021. Në paraqitjen e tij të parë para gjykatësit të procedurës paraprake, përkatësisht në datën 19 prill të vitit 2021, Shala është vetëdeklaruar i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës. Ky rast është ende në procedurë paraprake, kurse i pandehuri ndodhet në paraburgim që nga data e transferimit të tij në Hagë.

Gjatë periudhës janar - qershor 2022, në këtë rast janë mbajtur gjithsej tre (3) konferenca mbi ecurinë e çështjes. Në këto seanca kryesisht është diskutuar mbi dorëzimin e dosjes paraprake dhe përgatitjen për shqyrtimin kryesor. Në datën 28 janar të vitit 2022, ZPS-ja e ka dorëzuar dosjen paraprake, kurse me urdhër gojor të gjyqtarit të procedurës paraprake është caktuar data 31 gusht 2022 si datë paraprake për kalimin e dosjes së çështjes tek trupi gjykues.

**Prokurori kundër Hashim Thaqit dhe të tjerëve** - Të pandehurit Hashim Thaqi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi akuzohen nga ZPS për krime lufte dhe për krime kundër njerëzimit sipas të drejtës ndërkombëtare. Të pandehurit janë transferuar në objektin e paraburgimit në Hagë, më 4 dhe 5 nëntor 2020. Versioni i parë i aktakuzës kundër tyre është konfirmuar në datën 26 tetor të vitit 2020 dhe është bërë publik në datën 5 nëntor të vitit 2020. Ndërkohë, kjo aktakuzë ka pësuar edhe disa ndryshime duke përfshirë një numër akuzash të reja.

Gjatë periudhës janar - qershor 2022, në këtë rast janë mbajtur gjithsej tetë (8) seanca. Gjatë këtyre seancave është diskutuar kryesisht për afatet e nxjerrës së materialit provues të ZPS, materialet shfajësuese, masat mbrojtëse, të cilat janë duke u përdorur ndaj dëshmitarëve si dhe afatet mbi përgatitjen e hetimeve nga ana e mbrojtjes. Rasti është ende në procedurën paraprake dhe të pandehurit ndodhen në paraburgim.

## RASTI NË DHOMËN E SHKALLËS SË PARË

**Prokurori kundër Salih Mustafës** - I pandehuri Salih Mustafa akuzohet nga ZPS për krime të luftës sipas të drejtës ndërkombëtare. Mustafa është transferuar në njësinë e paraburgimit në Hagë në datën 24 shtator të vitit 2020. Aktakuza kundër tij është konfirmuar në datën 12 qershor të vitit 2020. Gjykimi në shkallën e parë ka filluar në qershor të vitit 2020 dhe deri në fund të qershorit të vitit 2022 janë dëgjuar gjithsej 29 dëshmitarë (14 të ZPS dhe 15 të Mbrojtjes). Në mesin e tyre ishin dhjetë (10) dëshmitarë anonim të propozuar nga ZPS, të cilat kanë dëshmuar për keqtrajtimet të cilat kanë ndodhur në qendrën e ndalimit në Zllash/Zlaš gjatë muajit prill të vitit 1999.

Gjatë periudhës janar - qershor 2022, në këtë rast janë mbajtur gjithsej njëzet e tetë (28) seanca. Procedura e paraqitjes së provave në këtë proces ka përfunduar. Seanca e radhës është caktuar për datën 13 shtator të vitit 2022, ku palët në procedurë do t'i parashtrojnë fjalët përfundimtare. Rasti është ende në gjykim dhe i pandehuri ndodhet në paraburgim që nga dita e arrestimit

# RASTET NË DHOMËN E APELIT

**Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt** - Të pandehurit Hysni Cucati dhe Nasim Haradinaj janë akuzuar për vepra penale kundër rendit publik dhe pengimit të administrimit të drejtësisë dhe administratës publike. Ata janë arrestuar më 25 shtator të vitit 2020 dhe janë transferuar në njësinë e paraburgimit në Hagë të Holandës. Aktakuza kundër tyre është konfirmuar në datën 11 dhjetor të vitit 2020 dhe më pas e njëjta është korrigjuar me datën 5 korrik të vitit 2021. Gjykimi në këtë rast ka filluar në datën 7 tetor të vitit 2021, kurse në datën 18 maj të vitit 2022 trupi gjykues, i kryesuar nga gjyqtari Charles L. Smith III, e ka shpallur aktgjykimin në këtë rast, ku i ka shpallur fajtor të pandehurit për tre vepra penale: shkelja e fshehtësisë së procedurës, frikësim gjatë procedurës penale, dhe pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare. Të dy të pandehurit janë dënuar me dënim unik prej katër (4) vite e gjashtë (6) muaj burgim. Tani procedura ndodhet në shkallën e dytë, pas apelimit të aktgjykimit nga pala mbrojtëse. Prokuroria ka njoftuar se nuk do të ankohet në vendimin e shkallës së parë. Gjatë periudhës janar - qershor 2022, në këtë rast janë mbajtur gjithsej trembëdhjetë (13) seanca.

Këtu mund ta lexoni komunikatën e FDHK me rastin e shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë në rastin kundër Gucatit dhe Haradinajt.

Gjatë periudhës janar - qershor 2022, para Dhomave të Specializuara të Kosovës në të gjitha rastet gjyqësore janë mbajtur në total pesëdhjetë e dy (52) seanca gjyqësore, duke i përfshirë këtu edhe konferencat mbi ecurinë e çështjes.

## GJETJET E FDHK:

Me rastin e shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë kundër Gucatit dhe Haradinajt, në po të njëjtën ditë është publikuar edhe aktgjykimi me shkrim, dhe ky veprim duhet vlerësuar, pasi që një praktikë e tillë është mjaftë transparente dhe profesionale për palët dhe opinionin e gjerë.

Më gjerësisht për rastet e krimeve të luftës në Kosovë mund të lexoni në raportet vjetore të publikuara nga Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, <https://hlc-kosovo.org/sq/publikimet>.



Ky publikim përkrahët financiarisht nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës përmes projektit "Avancimi i procesit të pajtimit përmes qasjes përfshirëse dhe holistike ndaj ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë" nga organizata "National Endowment for Democracy" përmes projektit të quajtur "Promovimi i dialogut dhe të kuptuarit historik".

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës dhe organizatës "National Endowment for Democracy".